

## PROCESI I TË LEXUARIT NË MËSIMNXËNIE

*Bota ka nisur herët së ekzistuari, por që të zhvillohej iu desh arsimi, studimi dhe leximi.*

*"Lexo!", pikërisht këtu e mori formën fjala e mendjes njerëzore.*

Që njeriu të marrë një informacion duhet të lexojë, të kuptojë dhe të meditojë rreth tij. Por çfarë është në vetvete procesi i të lexuarit, karakteristikat e lexuesit të mirë, aktivitetet dhe strategjitë e të lexuarit dhe si të përmirësojmë të lexuarin, do t'i shqyrtojmë në vija të përgjithshme në këtë material. Përzgjodha pikërisht trajtimin e temës së të lexuarit, sepse ne si popull kemi ngritur një mit, sipas të cilit jemi popull që lexojmë, por në fakt ky tipar gjithnjë e më shumë ka ardhur duke u zbehur, duke na kthyer në një popull le të themi të leximit online, apo digjital.

Njeriu nxë përgjatë gjithë jetës, si rrjedhojë atë e ndjek edhe leximi gjatë gjithë jetës.

Tashmë vërehen edhe efektet e para pozitive të aplikimit të teknologjisë në mësimdhënie, mirëpo duhet të njihet edhe fakti se për një zotërim më efektiv të këtyre shkathtësive, mësimdhënësit duhet të njohin shumë mënyra efektive të mësimdhënies së leximit, duke bashkëpunuar edhe me prindërit, që veprimtaria e tyre e nisur në shkollë të përforcohet në shtëpi. Të lexuarit të bën njeri më të mirë, të bën të lumtur, të zhvillon imagjinatën, të zgjeron njohuritë, të zhvillon aftësitë e të shkruarit. Librin e merr me vete dhe e lexon kudo, të lexuarit të përmirëson vetveten, të përmirëson të kuptuarit duke bërë të mundur që të njohim botëra pafund dhe imagjinare. Një lexues i mirë përdor forma të ndryshme leximi, përdor lexim të heshtur, kupton mirë synimet e leximit që po bën, zbaton rregulla drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimi gjatë leximit, sjell edhe përvojat e mëparshme për të arritur kuptimin e fjalëve.

Duke marrë aspektin profesional, shoh se dëshira e të lexuarit të nxënësve ka rënë në nivelet minimale të mundshme dhe kjo

gjë pengon drejtpërsëdrejti në cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Të lexuarit ka kaluar në plan dytësor, dhe kjo gjë pengon ngritjen e cilësisë arsimore. Metodatat me në qendër nxënësin synojnë që nxënësi të zhvillojë në klasë një lexim frontal dhe në shtëpi një lexim analitik.

Pastaj kur ndalemi te të lexuarit sipas funksionit, kemi tri ndarje:

1. Të lexuarit në funksion të të nxënës.
2. Të lexuarit artistik në funksion të kurrikulës arsimore.
3. Të lexuarit e letërsisë artistike ose e literaturës shkencore për kulturë, jashtë mureve të shkollës.

Institucioni i shkollës nuk nënkupton vetëm pjesëmarrje, por është edhe të jesh i pranishëm. Shkolla është një vend ku nxënës dhe të rritur bashkëveprojnë për të mësuar, për të udhëhequr dhe ku nxënësit priren të flasin hapur.

Ç'është të lexuarit?

Krahas të shkruarit, të folurit dhe të dëgjuarit, të lexuarit është një aktivitet mjaft i rëndësishëm, burim kryesor njohurish, mjet ndërlidhjeje dhe komunikimi. Ndaj dhe të lexuarit ka zënë dhe zë vend të veçantë në programet e lëndëve të leximit e të letërsisë në shkollë, por jo vetëm. Është e nevojshme që mësuesit të njohin mirë procesin e të lexuarit, si edhe të një mësimdhënieje efektive për të, që t'i aftësojnë nxënësit të bëhen lexues të mirë dhe aktivë gjatë gjithë jetës së tyre. Mësuesi duhet t'i bëjë nxënësit të aftë për t'u përfshirë në mënyrë të pavarur në veprimtarinë lexuese. Të lexuarit në fakt është saktësisht ai akt që lidh të shkruarit me lexuesin. *Deshifrimi, leximi i rrjedhshëm dhe leximi shprehës*, janë tri faza me rëndësi nëpër të cilat duhet të kalojë çdo lexim i kuptimshëm dhe i thelluar.

Shkrimtari i mirënjohur Viktor Hygo ka thënë: "Çdo fëmijë që mësohet, është një njeri që bëhet më i mirë". Ky aforizëm të fut në rrjedhën e të kuptuarit të vlerës dhe rëndësisë së të lexuarit dhe në rezultatet që sjell ai. Por çfarë duhet të kemi parasysh me të lexuarin?

Kemi përkufizime të ndryshme duke e nisur nga ato me eksplikitet, të cilat e konsiderojnë të lexuarit si një proces të identifikimit të fjalëve të shtypura, e deri te më implicitet si përkufizimi i Gaston Milare (Gaston Mialaret) që shprehet:

*“Të dish të lexosh, do të thotë të jesh i aftë ta transformosh një mesazh të shkruar në një mesazh sonor (tingullor,) duke ndjekur disa rregulla të përcaktuara, të kuptosh përmbajtjen e mesazhit të shkruar, si dhe aftësia për të gjykuar dhe vlerësuar vlerat estetike.”<sup>(1)</sup>*

Mësuesit e klasës së parë shpesh entuziazmohen kur fëmijët kanë përvetësuar mekanizmin e leximit dhe e përdorin mirë atë, pra kur kanë mësuar të *deshifrojnë*. Sigurisht që deshifrimi është një fazë fillestare e të lexuarit, pa të cilën nuk mund të mbërrihet te të lexuarit e mirfilltë, por të lexosh nuk do të thotë se shenjësi i gjendet përkatësja sonore(tingulli) dhe kaq, Të thuash këtë është joshteruese, joshpjeguese dhe s’është përfundimtar si konceptim rreth të lexuarit.

Leximi ose të lexuarit duhet marrë si një ndërveprim mes lexuesit, tekstit dhe kontekstit.

*“..të kuptuarit e leximit shpesh konsiderohet si rezultat i ndërveprimit ndërmjet lexuesit, tekstit dhe kontekstit”, “veprimi i të kuptuarit konsiderohet si një proces ndërtimi, që i/ e ndërthur kuptimin e nxjerrë nga teksti me njohuritë dhe përvojën e vetë lexuesit”.*<sup>(2)</sup>

Në rastin e leximit, të kuptuarit konsiderohet si proces ndërtimi që ndërthur kuptimin e tekstit me përvojën e lexuesit, pra lexuesi pasi e deshifron një tekst, ndërfut edhe përvojën e tij të njohjes së botës për të kuptuar këtë tekst. Leximin mund ta shikojmë edhe si një shikim eksplorues që shkon nga e përgjithshmja tek e veçanta, sepse çdo faqe është e rëndësishme dhe shpesh ndodh që fundi shpjegon fillimin, që do të thotë se duhet të shkojmë deri në fund që ta kuptojmë një tekst.

---

<sup>(1)</sup> Gaston Mialaret, *L'apprentissage de la lecture*, PUF, 16,1996.

<sup>(2)</sup> *Studio gjithçka, arsyet - vendin e parë*, AEDP, Soros.

Gjatë të lexuari na lind edhe një dëshirë për një rikrijim të tekstit sipas botëkuptimit tonë. Lexuesit që angazhohen në mënyrë tërësore, do ta shijojnë leximin dhe do të ngacmohen për të krijuar në mënyrë letrare.

Duke lexuar është e vetmja mënyrë që fëmijët të lexojnë rrjedhshëm dhe të kuptojnë atë që lexojnë dhe më pas të bëjnë edhe punë mendore individuale. Vetëm në këtë mënyrë ata e kuptojnë pasurinë dhe varietetin e madh të elementeve shprehës, si edhe aftësohen për të shfaqur mendimet dhe ndjenjat e tyre, duke përmirësuar kulturën e të folurit vetjak e duke kultivuar aftësitë individuale për komunikim.

Kush lexon një tekst duhet ta vërë theksin aty ku duhet dhe të shqiptojë drejt fjalitë, të modulojë pauzat dhe intonacionin, duke i dhënë kështu trajtë asaj forme të bashkuar në të cilën realizohet akti i të kuptuarit " ... *Sot, askush nuk është më në gjendje, përballë kërkesës për të lexuar një pjesë me zë të lartë, ta bëjë atë siç duhet, askush nuk di më të lexojë vërtet, duke ia vënë veshin theksit, mimikës, ritmit, pra muzikalitetit*"<sup>(3)</sup>

*Alain shprehet: "leximi është një shikim eksplorues, i cili shkon nga e përgjithshmja tek e veçanta, sepse çdo faqe është e rëndësishme dhe shpesh ndodh që fundi shpjegon fillimin..."*<sup>(4)</sup>

Kur themi të lexuarit, këtu bëhet fjalë që t'i stërvisim fëmijët të bëjnë lexim dhe shkrim të logjikshëm, sepse kjo do t'u vlejë në jetë. Kjo do të thotë rritje e aspektit dhe vlerësimit për përdorimin e gjuhës së shkruar dhe të folur në mënyrë të saktë dhe të përshtatshme, vetëdije për vlerat e teksteve letrare dhe joletrare për të pasuruar perceptimet, për të rritur sensin e identitetit kulturor dhe për të krijuar përvoja për kënaqësi estetike.

Nxënësit duhet të jenë subjekt për t'i nxitur të nxënit dhe të lexuarit.

**Lexo!:** Hapi i parë kërkon leximin dhe kuptimin.

**Dëgjo!:** Hapi i dytë kërkon ndarjen e ideve.

**Vlerëso!:** Hapi i tretë e përfshin nxënësin si partner në mësimdhënie, pasi kështu ai merr rëndësi dhe bëhet i besueshëm.

**Mobilizo!:** Hapi i katërt, bashkë me nxënësit, duke i përfshirë si partnerë, përmirëson të lexuarit.

<sup>(3)</sup> Gadamer, H.G *Historia e filozofisë* Tiranë, Plejad, (2008) f. 339).

<sup>(4)</sup> J. Loliber, R. Gloton, *La lecture*, 1975.

**Reflekto!:** Hapi i pestë i shtyn fëmijët që pas leximit të kenë reflektive.

### Ç'tipare ka një lexues i mirë?

Themi që lexueshmëria do përkushtim dhe vëmendje, por le të përshkruajmë më me detaje atë që mund të emërtohet një lexues i mirë. Sipas shumicës së gjuhëtarëve tanë, por edhe të huaj, një lexues i mirë kupton mirë synimet e leximit dhe zbaton rregullat e tij. Ai është i aftë të identifikojë informacionin e rëndësishëm në një tekst, duke sjellë njohuritë apo përvojat e tij të mëparshme dhe ndërton një kuptim të tij për atë tekst. Një lexues i mirë lexon për t'iu përgjigjur pyetjeve, për t'u argëtuar, apo për të mësuar nga një tekst i shkruar, pra ai bëhet i tillë kur përfshihet në një lexim të qëllimshëm e me kuptim.

Si çdo proces i të mësuarit, edhe të lexuarit nuk mund të bëhet pa një praktikë efikase. Nuk mund të konceptohet fillimi i të mësuarit duke e lënë fëmijën që të merret vetë me veten e tij. Ai duhet në fillim të njohë dhe pastaj të zotërojë mekanizmat që janë aq të domosdoshme në aktivitetin e tij. Fëmija mëson të flasë dhe krijon kështu gjuhën e folur. Atë që ai mëson është mënyra se si ai do të flasë. Gjuha e shkruar nuk është pra veçse një praktikë dhe është pikërisht kjo praktikë që mësohet. Leximi me shkrimin janë konsideruar shpesh si një disiplinë dhe si një praktikë dominuese. Të mësosh si të lexosh, si të shkruash, si të numërosh. Kështu e gjithë praktika gjuhësore kurorëzohet me të lexuarin. Autorë të ndryshëm kanë eksperimentuar për të provuar se "Leximi i hershëm është i mundshëm". Kështu D. Steinberg e M. Steinberg në librat e tyre *Të mësosh të lexosh para se të dish të flasësh*<sup>(5)</sup> dhe *Komunikimi dhe gjuha* (Nr. 30, 1976),<sup>(6)</sup> u kanë paraqitur fëmijëve të vegjël forma të shkruara dhe kanë vënë re se në 3 vjeç e gjysmë fëmija lexonte fjali të shkurtra. Kjo është e mundshme, sepse të mësuarit e procesit të leximit korrespondon me zhvillimin mendor dhe motorrik të fëmijës, karakteristikë kjo e moshës së re.

<sup>(5)</sup> *Të mësosh të lexosh para se të dish të flasësh*, D. Steinberg, (Nr. 30, 1976).

<sup>(6)</sup> M. Steinberg *Komunikimi dhe gjuha* (Nr. 30, 1976).

Më vonë, fëmijët 6-7 vjeç e kanë kaluar stadin e zbulimit të gjuhës, ata i afrohen mësimit të leximit përmes mësimit të gjuhës së shkruar, që shihet jo si një qëllim pedagogjik, por si një mjet. Të mësosh të lexosh do të thotë të formohesh si individ social që mendon dhe vepron, duke favorizuar kështu zhvillimin intelektual të fëmijës.

Ne vërtetë duhet t'i mësojmë fëmijët tanë sesi të lexojnë, por duhet edhe t'i lejojmë që ata të kenë edhe eksperiencat e tyre jetësore dhe të krijojnë një eksperiencë vetjake. Pra, le të stimulojmë zhvillimin e parakohshëm, në mënyrë që të kemi fëmijë intelektualë dhe më të zhvilluar.

Në veprën e tij, *Nga të folurit te leximi*, Lorenc Lentin (1979)<sup>(7)</sup> thekson se ideja e këtij lloji mësimi (edukimi i veshit), vënia në punë e një përvoje gjuhësore leksikore e sintaksore, zhvillimi i aftësive të të menduarit dhe të komunikimit, (veprime këto dominuese) do ta çojë fëmijën drejt shkrimit, e dashje pa dashje drejt leximit. Gjithashtu, do të arrijë realizimin e një pedagogjie interaktive ndërmjet fëmijës (që di pak), mësuesit (që di shumë më tepër) dhe fëmijëve të tjerë (që dinë më pak, por në forma të ndryshme).

Pra, fëmija ynë i cili është ushtruar në moshë të vogël, do të jetë rrjedhimisht një lexues dhe një nxënës i mirë.

Nëse fëmijët do ta provojnë ose jo pushtetin dhe bukurinë e gjuhës, kjo varet nga mësuesi. Ai duhet të bëjë që fëmijët - lexues ta shohin procesin e leximit si një proces kuptimi, si një aktivitet të përgjithshëm, e jo thjesht si një proces të identifikimit të fjalës. I gjithë ky proces, sa interesant aq dhe i ndërlikuar, nuk përvetësohet menjëherë, por gradualisht, duke kaluar nga leximi fillestar drejt leximit të pjekur, përmes mënyrave dhe metodave të ndryshme që e lehtësojnë atë dhe e bëjnë leximin të suksesshëm. Pra, është mësuesi në rolin e një dirigjenti, i cili e çon një fëmijë - lexues drejt cakut të suksesit.

### **Aktivitetet dhe strategjitë për të përmirësuar të lexuarin**

Shumë me rëndësi dalin edhe problematikat që shfaqin fëmijët në të gjitha nivelet e shkollimit. Shfaqen problematika në të lexuar, që vijnë nga neglizhenca, nga probleme logopedie,

<sup>(7)</sup> Lorenc Lentin, *Nga të folurit te leximi*, (1979).

dialektikë, nga shkaqe socio-ekonomike etj. Pra, ka edhe raste kur hasim një lexim sipërfaqësor, që sjell cilësi të dobët të të mësuarit. Në praktikën e sotme, gjithnjë e më shumë po diskutohen praktikën edukative dhe mësimore që stimulojnë dhe ndihmojnë të lexuarin. Le të përmendim disa nga aktivitetet që njih edhe didaktika e sotme, e mbështetur kjo në disa gjuhëtarë dhe metodistë vendas dhe të huaj.

### *Aktivitetet*

Një nga aktivitetet më të rëndësishme është ai i **leximit të drejtuar** (DRA) që realizohet përmes hapave të tilla, si: zhvillimi i konceptit, njohja e fjalorit, vendosja e qëllimeve për kuptimin, leximi i qëllimshëm gojor, aktivitetet etj.

Zhvillimi i konceptit ka të bëjë me motivimin e fëmijëve për të lexuar tregimin, duke përdorur piktura, objekte reale ose diskutime për temën e tij. Kështu, ne, më shumë motivojmë dhe nxisim imagjinatën e tyre. Ky hap i leximit të drejtuar është shumë i rëndësishëm për të ndihmuar nxënësit që të vënë në dukje përvojën e tyre në lidhje me përmbajtjen e tregimit. Një tjetër hap është prezantimi i fjalëve të reja, i cili duhet bërë në kontekstin e shkruar e duke ilustruar me fjalë të njohura. Pikërisht në këtë pikë mësuesi identifikon nxënësit se sa ata lexojnë, pra nëse janë studiozë dhe ata që nuk janë të tillë.

Kuptimi, interpretimi, vlerësimi, varen nga njohja e fjalëve dhe e kuptimeve të tyre. Nëse nuk do të dimë kuptimin e fjalëve të ndryshme, nxënësit do ta kenë të vështirë të kuptojnë ç'ka dashur të thotë autori në një tekst të caktuar. Mund të ndodhë që kuptimi i një fjale të merret me mend, por kjo mund të çojë në keqkuptime, apo kuptime jo të sakta.

Leximi me zë të lartë i çdo tregimi nga të gjithë nxënësit çdo ditë është i vështirë dhe kërkon shumë kohë, prandaj duhet të jetë më i kufizuar. Hapi i fundit në mësimin e leximit sipas kësaj metode përfshin aktivitetet praktike e zbatimet lidhur me tregimin.

**Metoda e përvojës gjuhësore (LEA).** Kjo metodë shihet si një proces komunikimi, lidhur ngushtë me komunikimin në të folur, në të dëgjuar e në të shkruar. Ajo integron mësimin e leximit. Fëmijët dëgjojnë, flasin, shkruajnë dhe lexojnë eksperiencat dhe idetë e tyre personale. Pra, ata dëgjojnë rreth pjesës, flasin rreth saj

dhe njëkohësisht lexojnë.

Harta e eksperiencave e ndihmon një orë mësimore të mirëfunksionojë, ku secili hedh eksperiencën e tij në lidhje me temën dhe përmbajtjen. Të tregojnë eksperiencat është bukur, sepse kur ata shkruajnë e më pas lexojnë eksperiencat e tyre, vëmendja është e plotë.

### *Biseda e drejtë dhe e zhdrejtë*

Në këtë praktikë le të themi, tregimi tregohet duke marrë nga një frazë secili fëmijë dhe duke e shkruar secili idenë me një ngjyrë të caktuar, me qëllim që të identifikojmë idetë e secilit nxënës...

### *Format e ndryshme të shkrimit*

Kjo është një metodë në formën e eksperimentit, pra ne e mësojmë mësimin e ri duke eksperimentuar, që do të thotë, nëse në mësuam ditarin, eksperimentojmë duke bërë një faqe ditar në grup.

### *Dialogu i shkruar*

Kjo mënyrë anashkalon komunikimin gojor dhe i lë hap ësirë komunikimit të shkruar, pra nxënësit komunikojnë me mesazhe të shkruara dhe të lexuara më pas.

### *Lexim me zë*

Mësuesi mund t'i vendosi nxënësit të lexojnë njëri pas tjetrit në mënyrë që të stërviten, por duke ndjekur modelin fillestar.

### *Përsëritja*

Kjo është metoda e rileximit të tekstit në heshtje, me vëmendje dhe me kuptim, që përmirëson të lexuarin dhe të kuptuarin.

Nga bashkëpunimi intensiv mësues-nxënës gjatë të lexuarit, arrihet nga ana e nxënësve-lexues që të identifikojnë llojin e strukturës së shkruar. Po ashtu, nga leximi, nxënësi krijon ide dhe jep gjykime.

Ka në fakt edhe shumë metoda të tjerat, që i ndihmojnë nxënësit të lexojnë, të kuptojnë dhe të ritregojnë më mirë, por shqyrtoam në mënyrë të përgjithshme ato metoda të cilat personalisht i kam praktikuar dhe me to kam arritur rezultate me nxënës të moshave

dhe niveleve të ndryshme të të nxënit.

S'na mbetet detyrë tjetër vetëm se të përmirësojmë sadopak të lexuarit e nxënësve tanë, pasi ata kanë nevojë të ndriçohen dhe të ndihmohen në rrugët e dijes.

Të lexuarit pa kuptuar atë që po lexohet nuk është lexim. Siç e përmendëm edhe më lart, shumë fëmijë janë në gjendje të shqiptojnë fjalët në mënyrë të rrjedhshme, por kur pyeten në lidhje me atë që sapo kanë lexuar janë të paaftë për t'u përgjigjur. Ndonëse kur bëhet fjalë për të lexuar rrjedhshëm dhe saktë këta nxënës mund të arrijnë rezultate të mira, në të vërtetë ata nuk janë lexues të mirë.

Çfarë e bën lexuesin, lexues të mirë? Lexues i mirë është ai që lexon me një qëllim të caktuar, qoftë për kënaqësi apo për të hulumtuar informacion. Lexuesi i mirë përfshihet në procese të ndërlikuara të të menduarit ndërsa lexon.

Ne mund të parashikojmë atë që do të studiojmë me nxënësit tanë, mund t'i paraqesim pamje vizuale, mund të ndërtojmë bllok pyetjesh rreth tekstit.

T'i ndihmojmë nxënësit tanë t'i rikthehen librit!

E nënvizojmë këtë duke pasur parasysh që leximi është shkathtësia më e rëndësishme që duhet të zhvillojë secili fëmijë gjatë shkollimit. Përveç të qenit shkathtësi themelore jetësore, leximi është thelbësor për nxënien e të gjitha lëndëve të tjera në shkollë.

## Burimet

- **Bergeron, B., Bradbury-Wolf, M.** (2003), *Të mësuarit e strategjive të të lexuarit në klasat fillore ~ Teaching Reading Strategies in the Primary Grades*, UK, Scholastic.
- **Garro, S.** (2002), *Mësimdhënia bashkëkohore*, Tiranë, Toena
- **Garro, S.** (2002), *Sfidat e mësimdhënies*, Tiranë, Erik design.
- **Gjokutaj, M.** (2009), *Didaktika e gjuhës shqipe*, Tiranë, ShBLU.
- **Karaj, Th., Rapti, E., Tamo, A.** (2005), *Mësimdhënia dhe të nxënët*, Tiranë, Mokra.
- **Lentin, L.** (1979), *Dal parlare al leggere*, Emme Edizioni.
- **Mialaret, Gaston** (1996), *L'apprendimento della lettura*, Romë, Armando Editore.